



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8105

Tirane, date 15/12/2015

Drejtuar: Z.WILLIAM CHIU
SHOQERIA "WILBE MINERAL& MINING INVESTMENT" SHPK
RRUGA "SAMI FRASHERI" PALLATI KONAD, KATI III, APART. 5
TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"
TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE
TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1623 date 03.04.2013.

I nderuar z. Chiu,

Shoqëria "Wilbe Mineral & Mining Investment" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1623 date 03.04.2013, për mineral Kromi, ne objektin "Gryka e Keqe" Tropoje, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse AKBN, ne mënyrë te përsëritur, me shkresat nr. 6179 date 22.06.2015 e nr.10128 date 25.11.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) respektivisht me nr.4707 date 24.06.2015 dhe 7708 date 25.11.2015, është propozuar revokimi i lejes nr.1623 date 03.04.2013, për mineral Kromi, ne objektin "Gryka e Keqe" Tropoje, Qarku Kukës sepse është ndërprere puna. Për ndërprerjen e punës dhe nuk është njoftuar siç përcaktohet ne shkronjat "d", "dh", "e" te nenit 18 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Gjithashtu me shkresën 8130 date 07.09.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.6025 date 08.09.2015, është propozuar përsëri për revokimin e lejes ne fjale, ne objektin "Gryka e Keqe", Tropoje, Qarku Kukës, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2015 - 2016.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur ne germën "c" dhe germën "ç" te pikës 1 te nenit 47 (neni qe përcakton shkeljet ligjore për te cilat një leje

revokohet) te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes minerare te shfrytëzimit nr.1623 date 03.04.2013, për mineral Kromi, ne objektin “Gryka e Keqe” Tropoje, Qarku Kukës, qe shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do te merret vendimi për revokimin e lejes nr.1623 date 03.04.2013, për mineral Kromi, ne objektin “Gryka e Keqe” Tropoje, Qarku Kukës.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë” duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

